



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 11 Maj 2023

Nr: 490

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 368 ID, NGA KOALICIONI PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA NDAJ MINISTRAVE DHE PERSONAVE PËRGJEGJËS NË DISA MINISTRI, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 11 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjet administrative me:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

SUBJEKT: A.

Zj. Ledina Agalliu, person përgjegjës në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit;
Z. Enea Hoti, person përgjegjës në Ministrinë e Brendshme;
Zj. Joana Duro, person përgjegjës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
Zj. Risena Xhaja, person përgjegjës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;
Zj. Edlira Zyfi, person përgjegjës pranë Ministrit të Shtetit për Standardet e Shërbimeve;
Z. Gazmend Turdiu, person përgjegjës në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme;

B.

Zj. Belinda Balluku, Zv. Kryeministër dhe Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë;
Zj. Mirela Kumbaro, Ministër i Turizmit dhe Mjedisit;
Zj. Elva Margariti, Ministër i Kulturës;
Z. Ulsi Manja, Ministër i Drejtësisë;
Z. Bledar Çuçi, Ministër i Brendshëm;



Zj. Ogerta Manastirliu, Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
Zj. Delina Ibrahimaj, Ministëri Financave dhe Ekonomisë;
Zj. Frida Krifca, Ministëri Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
Zj. Milva Ikonimi, Ministër i Shtetit për Standardet e Shërbimeve;
Zj. Elisa Spiropali, Ministrëri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin;
Zj. Edona Bilali, Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
Zj. Olta Xhaska, Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme;
Zj. Evis Kushi, Ministër i Arsimit dhe Sportit;
Zj. Bora Muzhaqi, Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ ndaj personave përgjegjës për shkelje administrative, për pastime, ripostime dhe përdorim hashtag në faqen e rrjetit social "Facebook"

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, neneve 91, 92, 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) ka depozituar, denoncime për të cilat pretendon se institucione publike (ministri) si dhe ministra kanë publikuar postime apo kanë ripostuar me përmbajtje partiake në faqet zyrtare të rrjetit të tyre social "Facebook", të cilat përbëjnë përdorim të burimeve publike.

Subjektet e denoncuara janë si më poshtë vijon:

- 6 (gjashtë) ministri;
- 14 (katërmëdhjetë) ministra.

Denoncimi është administruar, nëpërmjet raportit të KRIIK, të datës 2 Maj 2023, "Për gjetjet dhe rekomandimet për javën 21- 27 Prill 2023".

Neni 19, pika 1, shkronja "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Data: 11 Maj 2023 Nr: 490
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 368 ID për shkelje administrative"

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t'u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundravajtjet administrative", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Në vijim të procedurës administrative, filloi shqyrtimi administrativ, duke verifikuar provat si dhe duke kërkuar informacion në lidhje me publikimet e postuara apo ripostimiet me përmbajtje elektorale, slogane dhe # hashtag.

Denoncuesi ka paraqitur pretendime si më poshtë vijon:

Denoncim regjistruar me nr. 368 ID, ndaj Ministrive dhe Ministrave, me kërkues KRIIK, ku pretendohet si më poshtë vijon:

"Me aktivitetin e hapjes së fushatës elektorale nga Partia Socialiste, në datën 11 prill 2023, kjo e fundit bëri publike edhe sloganin e fushatës elektorale për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Konkretisht, slogani i fushatës #VetëmPërpara #KurrëMëMbrapa.

*KRIIK ka vërejtur që këto slogane, shoqërojnë thuajse çdo postim, pavarësisht se ato janë me natyrë institucionale, në faqet zyrtare në rrjetin social Facebook të Kryeministrit, Ministrave, Deputetëve, Kryetarëve të Bashkive, etj., të cilët kanë llogari aktive në rrjetet sociale. Këto sloganë, të konvertuara dhe përdorura edhe si **hashtag-e lidhen dhe identifikojnë drejtpërsëdrejt Subjektin Zgjedhor "Partia Socialiste"**.*

Postime të shoqëruara me përdorimin e hashtag-eve të sipërpërmendura gjenden në Faqet Zyrtare të Ministrive dhe Ministrave,

A.

1. Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
2. Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Brendshme;
3. Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
4. Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
5. Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Shtetit për Standardet e Shërbimeve;
6. Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme;

Data: 11 Maj 2023 Nr: 490
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 368 ID për shkelje administrative"

B.

1. Faqja zyrtare në Facebook e Zv. Kryeministres dhe Ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë;
2. Faqja zyrtare në Facebook e Ministres së Turizmit dhe Mjedisit;
3. Faqja zyrtare në Facebook e Ministres së Kulturës;
4. Faqja zyrtare në Facebook e Ministrit të Drejtësisë;
5. Faqja zyrtare në Facebook e Ministrit të Brendshëm;
6. Faqja zyrtare në Facebook e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
7. Faqja zyrtare në Facebook e Ministres së Financave dhe Ekonomisë;
8. Faqja zyrtare në Facebook e Ministres së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
9. Faqja zyrtare në Facebook e Ministres së Shtetit për Standardet e Shërbimeve;
10. Faqja zyrtare në Facebook e Ministres së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin;
11. Faqja zyrtare në Facebook e Ministres së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
12. Faqja zyrtare në Facebook e Ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme;
13. Faqja zyrtare në Facebook e Ministres së Arsimit dhe Sportit;
14. Faqja zyrtare në Facebook e Ministres së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ për denoncimet e regjistruara me nr. **368 ID**, pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të tyre, provohet se të gjitha postimet dhe ripostimet në faqet zyrtare të rrjetit social "Facebook", të institucioneve subjekt i këtij denoncimi, janë përdorur hashtag dhe slogane me përmbajtje elektorale.

Nga verifikimet paraprake dhe provat e administruara vlerësoj se faqet e rrjetit social "Facebook", nën emrat e Ministrive apo Ministrave, janë faqe zyrtare të këtyre institucioneve.

Kodi Zgjedhor në nenin 91, pika 1 parashikon se *"Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administruar të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia". Po ky nen parashikon se "burime" quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit.*

Vënia në dispozicion e faqeve zyrtare në "facebook" apo çdo mjeti tjetër komunikimi elektronik (media sociale) të institucioneve publike për publikimin e postimeve apo nëpërmjet ripostimit të postimeve të cilat përmbajnë hashtag #, slogane me karakter politik/elektoral në zgjedhje, apo thirrje për mbështetje në zgjedhje nga ana e këtyre institucioneve përbën përdorim të burimeve publike.

Data: 11 Maj 2023 Nr: 490
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 368 ID për shkelje administrative"

Në kushtet ku institucionet publike si **Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shtetit për Standartet dhe Shërbimet, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**, objekt denoncimi, kanë bërë një sërë ripostimesh të cilat përmbajnë hashtag # dhe slogane me karakter politik/elektoral, duke keqpërdorur këto llogari institucionale që përbëjnë burim publik. Për pasojë vlerësohet se jemi përpara një shkelje administrative të Kodit Zgjedhor, nga këto institucione publike pasi vërehet qartazi promovimi i subjekteve zgjedhore, në zgjedhjet vendore të 14 Maj 2023.

Po ashtu për sa i përket denoncimit nr. **368 ID, pika A, nënpika 1**, objekt shqyrtimi, nga verifikimi paraprak në fazën e administrimit të denoncimit dhe më pas të shqyrtimit, ndaj postimeve në rrjetin social “Facebook”, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, rezulton që nuk ka asnjë postim me përmbajtje elektorale sikurse pretendohet nga denoncuesi. Në këto kushte vlerësohet se duhet të pushohet procedimi administrativ për këtë ministri.

Lidhur me denoncimin nr. **368 ID, pika B**, për sa i përket faqeve personale të ministrave, objekt shqyrtimi **theksojmë** se postimet në llogaritë personale në “facebook” të tyre, nuk mund të përbëjnë prova të mjaftueshme për të provuar lidhjen midis postimit dhe shkeljes administrative. Ministri ashtu si dhe kryetarët e bashkive gëzojnë edhe funksionin politik dhe si i tillë mund të postojnë në faqen personale mesazhe politike, promovim të nismave politike, festimi i arritjeve politike apo çdo lloj mesazhi tjetër politik. Marrëdhëniet personale apo postimet në llogaritë personale në facebook të tyre, dalin jashtë fushës së zbatimit dhe objekti të rregullimit të Kodit Zgjedhor dhe akteve normative në fuqi dhe si të tilla nuk mund të trajtohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Parashikimi i ndalimeve për sa i përket këtyre postimeve me natyrë politike interferon në liritë themelore siç janë liria për t’u shprehur si dhe liritë dhe të drejtat politike. Për pasojë duhet të pushohet shqyrtimi administrativ për kryetarët e bashkisë dhe ministrat objekt denoncimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se rasti objekt denoncimi regjistruar me nr. **368 ID**, për rastin e *Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Shtetit për Standartet dhe Shërbimet, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme*, të marra në hetim administrativ përbën shkelje të nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe duhet t’i tërhiqet vëmendja të përsoneve përgjegjës në mënyrë që të tregohet kujdes në publikimin e postimeve të ndryshme që përmbajnë slogane apo hashtag # me përmbajtje elektorale. Për rrjedhojë, referuar nenit 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 (tre mijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenin 91, 92, 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

V E N D O S:

1. T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, në vlerën 3 000 (tre mijë) lekë për:
 - z. Enea Hoti, person përgjegjës në Ministrinë e Brendshme;
 - zj. Joana Duro, person përgjegjës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
 - zj. Risena Xhaja, person përgjegjës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;
 - zj. Edlira Zyfi, person përgjegjës pranë Ministrit të Shtetit për Standardet e Shërbimeve;
 - z. Gazmend Turdiu, person përgjegjës në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.
2. Moskonstatimin e shkeljes dhe pushimin e procedimit administrativ ndaj zj. Ledina Agalliu, person përgjegjës në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.
3. Pushimin e hetimit administrative ndaj:
 - Zj. Belinda Balluku, Zv. Kryeministër dhe Ministrër i Infrastrukturës dhe Energjisë;
 - Zj. Mirela Kumbaro, Ministër Turizmit dhe Mjedisit;
 - Zj. Elva Margariti, Ministër i Kulturës;
 - Z. Ulsi Manja, Ministër i Drejtësisë;
 - Z. Bledar Çuçi, Ministër i Brendshëm;
 - Zj. Ogerta Manastirliu, Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
 - Zj. Delina Ibrahimaj, Ministër i Financave dhe Ekonomisë;
 - Zj. Frida Krifca, Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
 - Zj. Milva Ikonomi, Ministër i Shtetit për Standardet e Shërbimeve;
 - Zj. Elisa Spiropali, Ministrër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin;
 - Zj. Edona Bilali, Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
 - Zj. Olta Xhaka, Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme;
 - Zj. Evis Kushi, Ministër i Arsimit dhe Sportit;
 - Zj. Bora Muzhaqi, Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;
4. Urdhërimin e fshirjes së menjëhershme nga faqet zyrtare të rrjetit social “Facebook”, të secilës Ministri, të çdo postimi apo ripostimi në të cilat janë përdorur hashtag me përmbajtje elektorale.

5. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Kopje: 4

Afati i ruajtjes: 5 vjet

Punoi:

I.Horanlliu _____

M.Koja _____

A. Lamçe _____

Y.Merkaj _____

Data: 11 Maj 2023 Nr: 490
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 368 ID për shkelje administrative”